



---

MUAJI NDËRKOMBËTAR I GRUAS  
MARS 2014  
MESAZH I PËRBASHKËT

---

Gjatë Muajit Ndërkombëtar të Gruas, ne, si përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar në Shqipëri dhe si anëtarë të grupit teknik të punës mbi 'Gratë në Vendim-marrje', reflektojmë mbi përparimin e bërë deri më sot, dhe sfidat që mbeten drejt arritjes së barazisë gjinore në Shqipëri.

Ne mbështesim plotësisht temën e Kombeve të Bashkuara për Ditën Ndërkombëtare të Gruas për këtë vit, "Barazia për Gratë është Progres për të Gjithë." Nga vendet anembanë globit dëshmohet përditë e më shumë se barazi më e madhe për gratë do të thotë prosperitet më i madh për mbarë shoqërinë. Në vitin 1945, Karta e OKB-së themeloi parimin e barazisë midis grave dhe burrave si një nga shtyllat kryesore të progresit demokratik. Kjo është e vërtetë për Shqipërinë sot, njëzet e tre vjet pas fillimit të demokracisë.

Ne qëndrojmë së bashku me një mesazh të përbashkët: gratë dhe vajzat e këtij vendi kanë të drejtë të marrin pjesë në mënyrë të barabartë, pa u diskriminuar, në të gjitha sferat e jetës publike. Masat efektive në përforcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe politikave anti-diskriminuese janë një prioritet kyç për Shqipërinë për të ecur përpara në përmbushjen e aspiratave të qytetarëve të saj drejt Bashkimit Europian. Për më tepër, pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave në vendim-marrjen politike dhe publike, sipas Rekomandimit të Këshillit të Europës të vitit 2003, inkurajon shtetet bashkë-anëtare të promovojnë përfaqësimin e grave në jetën politike apo publike në një nivel jo më pak se 40%.

Ne përgëzojmë qeverinë për përmbushjen, për herë të parë, të kuotës 30% në përfaqësimin e grave në Kabinetin e Ministrave. Rishikimet e ligjit para zgjedhjeve të Qershorit 2013, ofruan gjithashtu një mundësi për të rritur numrin e grave në Kuvend; fatkeqësisht, gratë vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuar në postet publike, përfshirë edhe Kuvendin, siç theksohet edhe në Raportin e Progresit 2013 të Komisionit Europian dhe Raportin e Këshillit të Përhershëm 2013, të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Ne u bëjmë thirrje partive politike që t'u përmbahen akteve ligjore në fuqi, lidhur me renditjen e grave në listat e kandidatëve, dhe nëse është e mundur të tejkalojnë këto dispozita për të treguar angazhim ndaj barazisë gjinore në vendim-marrje. Ne nxisim Parlamentin, Qeverinë, dhe të gjitha partitë politike në ndërmarrjen e hapave konkretë për krijimin e një mjedisi, i cili u mundëson grave shqiptare avancimin në poste politike dhe publike. Ne mbështesim përpjekjet e përbashkëta të organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të grave që punojnë në përparimin e barazisë gjinore në Shqipëri.

Zgjedhjet lokale të vitit të ardhshëm ofrojnë një mundësi për të bërë pikërisht këtë. Ne nxisim të gjitha partitë politike për të rritur rolin e kandidatëve gra në të dyja nivelet, atë të këshilltarit dhe të kryetarit të bashkisë ose komunës. Përveç kësaj, ne besojmë se dispozitat gjinore në Kodin Zgjedhor duhet të forcohen më tej.

Si partnerë ndërkombëtarë të Shqipërisë, ne jemi të angazhuar për të siguruar mbështetjen e nevojshme dhe ekspertizën teknike për të ndihmuar në arritjen e këtyre qëllimeve. Hapat e parë janë



hedhur: ligjet janë miratuar ose po draftohen. Tani është koha që ato të kenë efekt dhe të zbatohen në të gjitha fushat ku pozita e gruas vihet në diskutim.

Bindja jonë është se respektimi i të drejtave të grave përbën thelbin e respektimit të shtetit të së drejtës në shoqëri. Gjatë Muajit Ndërkombëtar të Gruas, le të theksojmë edhe një herë angazhimin tonë të përbashkët për të drejtat e grave dhe le të ecim përpara të bindur se barazia për gratë është progres për të gjithë.